



Datë: 14.05.2025
Numër Protokolli: 3792/2025

A.nr.463/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.463/2025, të datës 13.03.2025, të parashtruar nga ankuesi N.A., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Selmani Krasniqi avokat nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit: Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “*kundërshtim i masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 14.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.463/2025, e datës 13.03.2025, e parashtruar nga ankuesi N.A.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KD.nr.15/2024, të datës 13.02.2025 i Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, N.A. (*tutje referuar vetëm* Ankuesi), më datë 10.03.2025, përmes postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 13.03.2025, dhe e regjistruar nën shenjën A.nr. 463/2025, kundër Vendimit me numër KD.Nr.15/2024, të datës 13.02.2025, të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, për të cilin të njëjtit i është shqiptuar masa disiplinore “*Pezullim nga pozita pa pagesë për gjashtë (6) muaj*”. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: SHKK*), ndërsa, ky i fundit, me datë 25.03.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1643/2025 të datës 13.03.2025 të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 27.02.2025; Vendimin me numër KD.Nr.15/2025 të datës 13.02.2025 të Komisionit Disiplinor në SHKK; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 25.03.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i

punësimit; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës 01.07.2018; Përshkrimin e detyrave të punës për ankuesin; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 06.07.2024; Flete kthesën me numër KD:Nr.15/2024 të datës 20.08.2024; Vendimin me numër KD:Nr.15/2024 të datës 15.08.2024; Procesverbalet e datës 24.07.2024; Kërkesën e datës 07.08.2024; Ftesën e datës 23.07.2024; Kërkesën e datës 08.08.2024; E-mailin e datës 12.02.2025; Aktvendimin me Nr.2024:0043375 të datës 06.01.2025; Raporti me numër protokolli Nr.615 i datës 12.02.2024; Vendimin me numër Nr.594 të datës 08.07.2024; Informatat për të burgosurin F.H të datës 24.05.2024; Formulari i Llogaritjes së Dënimit ED.NR.4/23 të datës 16.01.2023; Aktgjykimin P.nr.370/22 të datës 25.11.2022; Letërreshtimi i datës 06.07.2025; Kallëzim penal të datës 08.07.2024; Forma e planifikimit të vizitave 04.01.2023; Kartoni i evidencës të vizitorëve; Dëshminë e datës 27.05.2024; Certifikatën e martesës 03.03.2021; Kërkesën e datës 29.06.2024; Kërkesën e datës 25.06.2024; Kërkesën e datës 05.06.2024; Kërkesën e datës 31.05.2024; Kërkesën e datës 16.01.2024; Vendimin e datës 24.05.2024; Vendimin e datës 08.03.2024; Lejen për pushim në shtëpi; Kërkesën nga i burgosuri për transferim të datës 25.11.2022; Raportin e datës 01.02.2024; Raportin e sigurisë 21.05.2024; Vendimin e datës 06.06.2024; Rivlerësimin për benificione të datës 05.06.2024; Kërkesën e datës 03.06.2024; raportin mjekësor të datës 30.05.2024; Raportin mjekësor të datës 07.05.2024; Raportin mjekësor të datës 22.03.2024; vendimin KD.014/015/016/2024 të datës 11.02.2024 të Komisionit Disiplinor; Vendimin nr. prot.2701/2025 të datës 23.04.2025, të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pa bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Kontratës së Punës së datës 01.07.2018, është i punësuar në pozitën *Zyrtar Korrektues*, në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Tutje sipas shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar këtë gjendje faktike:

- Udhëheqësi për Punë Juridike dhe të Përgjithshme, në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë, përmes shkresës me numër protokolli 000447/24 të datës 06.07.2024, ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankuesit, për shkak të supozimit për moskryerje të detyrave të punës me rastin e Largimit (Arratisjes) të të dënuarit F.H nga QK në Smrekonicë, përkatësisht për shkelje të rregullave të punës, të përcaktuar sipas përkatësisht nenit 56 paragrafit 4 nën paragrafit 4.1 dhe nenit 58, paragrafit 3 nën paragrafit 3.11 dhe 3.12, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

-Komisioni Disiplinor i SHKK-së më Vendimin KD.nr.015/24, të datës 06.07.2024, pas pranimit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, ka pezulluar përkohësisht nga puna ankuesin bazuar në nenin 59 paragrafi të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe nenit 56 paragrafit 4 nën paragrafi 4.1, të Ligjit Nr. 08/L-187 për Zyrtarët Publik, për shkak se besohet se ka arsye se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga ankuesi, për të cilin ka filluar procedura disiplinore lidhur me rastin e dyshimit të arratisjes së të burgosurit F.H, e pengon hetimin disiplinor apo mund të cenoj ushtrimin e përshtatshëm të detyrës.

-Komisioni Disiplinor i ShKK-së, bazuar në raportin Nr.Ref:08/1-01-871/2024 DKR, të datës 07.08.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, më datë 15.08.2024, ka nxjerrë Vendimin KD.nr.15/2024, përmes të cili akt ka pezulluar procedurën e iniciuar disiplinore ndaj ankuesit, ndërsa, ka lënë në fuqi Vendimin KD.nr.015/24 të datës 06.07.2024, me arsyetimin se ShKK, lidhur me rastin e arratisjes së të paraburgosurit në F.H, ka pranuar kërkesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, përmes së cilës ka njoftuar se lidhur me rastin janë duke u zhvilluar hetime me autorizim të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

-Komisioni Disiplinor i SHKK-së më Vendimin KD.nr.014/015/016/2024, të datës 15.08.2024 ka aktivizuar procedurën disiplinore ndaj ankuesit, e pezulluar sipas Vendimit nr.15/2024 të datës 15.08.2024, mbi arsyetimin se më datë 06.01.2025 Komisioni ka pranuar Aktvendimin me numër të lëndës 2024:0043375, të Prokurorisë Themelore Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, Prokurori i Shtetit, me të cilin aktvendim ka pushuar procedura penale dhe hetimet e filluara sipas Aktvendimit PP.II.nr.1186/24 të datës 18.07.2024, mbi bazën e kallëzimeve penale të paraqitura nga Stacioni Policor-Vushtrri, me nr. rasti 2024-BD-608 të datës 12.07.2024 dhe ShKK-së të datës 08.07.2024, kundër të pandehurit F.H.

-Komisioni Disiplinor i ShKK-së, më Vendimin më numër protokoll KD.Nr. 15/2024, të datës 18.02.2025, ka shpallë përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore, të paraparë me nenin 58, paragrafi 3, nën paragrafët 3.4, 3.11 dhe 3.12 të Ligjit Nr.08/L-031 për Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe nenit 56, paragrafi 4, nën paragrafit 4.1, 4.4 dhe 4.20 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke i shqiptuar të njëjtit masën disiplinore të përcaktuar nga neni 57, paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të këtij ligji dhe nenit 15, paragrafit 3, nën paragrafit 3.5 të Rregullores Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, *“Pezullim nga pozita pa pagesë për gjashtë (6) muaj”*.

Ankuesi, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë përmes përfaqësuesit të autorizuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Vendimin më numër protokoll KD.Nr.15/2024, të datës 18.02.2025, të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, shkeljes së dispozitave procedurale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën time si të bazuar dhe ta anuloj Vendimin e Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës me numër KD.Nr.15/2024 të datës 10.03.2025.

Në kuptim të kompetencës së Këshillit në pikëpamje materiale, Kolegji i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 6, ku përcaktohet se : *“1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. 3. Ne rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë..”* dhe si rrjedhojë referuar këtij përcaktimi ligjor rezulton fakti së të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës kanë statusin e veçantë të nëpunësit civil, dhe së ligj të veçantë mund të rregullohet ndryshe dhe në mënyra të veçantë procedura disiplinore e nëpunësve civil të këtij institucione si dhe të përcaktohen shkelje dhe masa disiplinore tjera nga ato të përcaktuar me ligjin bazik për zyrtarët publik.

Rrjedhimisht, nisur nga konstatimi si me sipër, Kolegji i Këshillit në trajtimin e kësaj çështje juridike-administrative mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, si ligj i veçantë, gjegjësisht: nenin 58 ku përcakton se: *“1. Përveç shkeljeve të parapara në Ligjin për Zyrtar Publikë, personeli i SHKK-së përgjigjen edhe për shkeljet disiplinore të veçanta...3. Shkelje të rënda disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen: 3.1.vjedhja, mashtrimi, falsifikimi i dokumenteve zyrtare; 3.2. dëmtimi i pronës; 3.3 .ardhja në punë nën ndikimin e alkoolit apo të substancave narkotike, ose përdorimi i tyre gjatë orarit të punës; 3.4. shkeljet serioze e rregullave të*

sigurisë; 3.5. zbulimi i të dhënave apo informatave koifidenciale; 3.6. jep deklarata publike për Shërbimin Korrektues, pa autorizim të Drejtorit Përgjithshëm; 3.7. shfrytëzon në mënyrë të palejuar titullin apo autoritetin e tij për përfitim personal; 3.8. jep informata për të burgosurit pa autorizim; 3.9. ngacmimit seksual i ndonjë të burgosuri, të punësuar apo vizitorit; 3.10. diskriminimi ne çfarëdo forme ose keqtrajtimi i drejtpërdrejtë ose tërthorazi kundër të burgosurve, zyrtarëve ose të punësuarve tjerë; **3.11. mos veprimi apo lënja pas dore e detyrës së tij si zyrtar korrektues;** **3.12. mosveprimi në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme të punës;** 3.13. me vetëdije apo me pakujdesi lëshon ose nënshkruan deklaratë të rremë në lidhje me përmbushjen e detyrës; 3.14. duke qenë përgjegjës, apo person me autoritet, injoron apo nuk ndërmerr masa kur një punonjës shkelë rregullat dhe detyrat e punës; 3.15. nuk i raporton autoritetet më të larta mbi çdo mall kontrabandë që zbulon tek ndonjë punonjës, i burgosur apo anëtar tjetër të publikut; 3.16. nga pakujdesia rrezikon ose shkakton dëme fizike apo vdekjen e ndonjë të burgosurit punonjësi tjetër të Shërbimit apo personi tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi; 3.17. përdorë forcën e cila nuk është e kufizuar në intensitetin dhe zgjatjen e saj deri në atë masë që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim; 3.18. përdorë mjetet për përdorimin e forcës në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e Shërbimit Korrektues; 3.19. lejon ose mundëson arratisjen e ndonjë të burgosuri; 3.20. nuk ndërmerr masat e duhura, që ka, kur ndonjë i burgosur shkelë rregulla e brendshme, sulmon një punëtor, të burgosur tjetër, ose anëtarë të publikut; 3.21. nuk jep llogari, mban pa vend, dhe keqpërdorë të hollat e pronën e publikut apo të hollat/pronën e çdo personi tjetër që i bien në dorë gjatë kryerjes së detyrës së tij; 3.22. flenë gjatë orarit të punës; 3.23. detyron, nxit apo përpiket që me çdo kusht të detyrojë një punonjës tjetër të marrë pjesë në punë ilegale apo të palejuar, apo në shkeljen e standardeve të etikës profesionale; 3.24. nuk bën raportimin të menjëhershëm të një incidenti në institucion; Përleshet me punëtorët tjerë të Shërbimit apo ndonjë anëtar tjetër të publikut gjatë detyrës; 3.25. fut apo nxjerr nga burgu kontrabandë apo sende të pa lejuara; 3.26. nuk raporton te zyrtarët kompetent, rastet e keqtrajtimit të të burgosurve nga ana e punëtorëve tjerë; 3.27. nuk raporton dhe nuk merr masa ndaj shkeljeve nga të burgosurit, konform dispozitave ligjore; 3.28. fsheh, mban, injoron, dëmton apo asgjëson ndonjë ankesë apo raport të bërë kundër ndonjë zyrtari ose të burgosuri; 3.29. keqpërdorimi i armës zyrtare apo humbja e saj..si dhe nenin 59, i cili përcakton se: “1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj personelit SHKK-së, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në katër dhjetë për qind (40%) e pagës për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 1.3. transferimi në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj; 1.4. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy(2) deri në pesë (5) vjet; 1.5. ulje në pozitë; 1.6. largimi nga shërbimi civil. 2. Procedura disiplinore zhvillohet ne pajtim me ligjin për zyrtarët publikë. 3. Procedura dhe shqiptimi i masave disiplinore rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë..”.

Bazuar në kuadrin ligjor si më sipër e duke ju referuar edhe nenit 86 të LPPA-së, Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar me ankesë, në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje administrative dhe si rrjedhojë konstatoi së Komisioni Disiplinor duke vendosur në procedurë disiplinore ndaj ankuesit të iniciuar sipas kërkesës së datës 06.07.2024, ka vërtetuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike, dhe në këtë mënyrë ka zbatuar drejt ligjin material, sepse sipas Raportit të Inspektoratit të Drejtësisë, më numër protokolli 592, të datës 08.07.2024, si dhe Raporti Hetimor të Komisionit të SHKK-së më numër protokolli 615, të datës 12.07.2024, si dhe provave materiale të përcjella në përgjigjen në ankesë, vërtetohet së ankuesi natën e arratisjes së të burgosurit F.H gjegjësisht më datë 05-06.07.2024, ka qenë i caktuar për kryerjen e detyrave të punës në pavion së bashku me zyrtarin F.R i caktuar në dhomën e kontrollit, ndërsa, rreth orës 23:35, kohë kjo e regjistruar sipas kamerave të vendosura, i burgosuri F.H. ka arritur të arratiset nga Qendra Korrektuese e Semerkonicës pa u vënë fare re nga ankuesi, veprime këto të ankuesit që bien ndesh më detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pozitën e zyrtarit korrektues. E në kontekst të përgjegjësisë, Kolegji thekson faktin së bazuar në përshkrimin e detyrave të punës zyrtari korrektues është përgjegjës për: **mbajtjen dhe kontrollin e të burgosurve, paraburgosurve në pajtim me rregullat dhe dispozitat ligjore, të siguroj ambient sa me të**

sigurt për të burgosurit/paraburgosurit, personelin dhe vizitorët, të mbikëqyr, kontrolloj dhe monitoroj lëvizjet dhe aktivitetet e të burgosurve/paraburgosurve brenda dhe jashtë institucionit, të bëjë verifikimin e sigurisë institucionale...

Andaj, bazuar në konstatimet dhe të gjeturat si me lartë, Kolegji erdhi në përfundim se në veprimet dhe mosveprimet e ankuesit manifestohen të gjitha elementet e shkeljes disiplinore sipas nenit 58 paragrafi 3 nën paragrafi 3. nën paragrafët 3.4, 3.11, dhe 3.12 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërlidhur me nenin 5,6 paragrafi 4, nënpargrafet 4.1, 4.4 dhe 4.20 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, kështu që, më të drejtë Komisioni Disiplinor ka shpallur përgjegjësin ankuesin dhe ka shqiptuar masa disiplinore në proporcion me shkeljen e ndodhur, andaj, Kolegji i Këshilli në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të refuzoj si të pa bazuar ankesën duke lenë në fuqi si të ligjshëm Vendimin KD.nr.15/2024, të datës 13.02.2025 i Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.463/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit Selami Krasniqi;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.